

**KONTRATE
SHITJE KUOTASH**

Sot me date 01. 04. 2022 (dymijenzjet e dy), lidhet kjo kontrate e shitje se kuotave te pjesëmarrjes ne kapitalin e regjistruar te shoqërisë "M.B INVEST" sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C, me seli ne Tirane Njësia Administrative nr. 7, Rruga "Nikolla Lena", Godina nr. 79, Nr. Pasurie 109/234-G1/3, Zone Kadastrale Nr. 3292 midis palët si me poshtë:

SHITES; Znj. Miranda Thoma Boçi, lindur me 26.11.1967, ne Lushnje dhe banues ne Tirane, identifikuar nëpërmjet kartës se identitetit Nr. Personal G20101669F, madhorë, me zotësi te plota juridike dhe për te vepruar, zotëruese e 1 kuotë që korrespondon me 100% te kapitalit ne shoqërinë tregtare "M.B INVEST" sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C.

BLERES;

Z. Abaz Nezir DINO, shtetas Shqiptar, lindur me 29.01.1967 ne Ballsh dhe banues ne Tirane, ne Rr. "Rrapo Hekali", pranë Kultit "Eleonor" Selitë, Tirane, madhor e me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 024472278 dhe Nr. personal G70129065N.

BAZA LIGJORE; Referuar dispozitave ligjore: -Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar. -Ligji Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" me ndryshimet e mëvonshme. -Kodi Civil -Akt Themelim e Statut i Shoqërisë.

OBJEKTI; Shitje e tërësisë se kuotave te zotëruara nga shitësi, znj. Miranda Thoma Boçi ne shoqërinë tregtare "M.B INVEST" sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C te blerësi dhe blerja nga z. Abaz Nezir DINO te një kuote ne masën e 100% te kapitalit themeltar.

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate znj. Miranda Thoma Boçi humb tërësisht te drejtat e pronësisë mbi kuotën e zotëruar nga ana e saj deri para nënshkrimit te kësaj kontrate ne shoqërinë tregtare "M.B INVEST" sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C si dhe çdo te drejte reale qe buron nga zotërimi i kuotës deri me tani apo dhe detyrim te tij me këtë shoqëri, pronësi e cila me regjistrimin e kësaj kontrate ne QKB kalojnë plotësisht te;

- Z. Abaz Nezir DINO te një kuote ne masën e 100% te kapitalit themeltar kundrejt vlerës totale 100 000 leke (njëqind mije leke). Çmimi, vlera monetare, e këtij transaksioni është likuiduar ne zyrat e Shoqërisë pa patur pretendim mes tyre ku shitësi deklaroi se i ka marre ato.

Mbas nënshkrimit te këtij Akti e pasqyrimit e tij ne QKB, Shoqëria tregtare "M.B INVEST" sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C pëson këto ndryshime:

Ishte: Shoqëria tregtare "M.B INVEST" sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C, dhe me një kuote me Ortake te Vetëm: znj. Miranda Thoma Boçi zotëruese e 1 (një) kuote me vlere 100% te kapitalit ne Shoqëri.

Behet: Shoqëria tregtare "M.B INVEST" sh.p.k. te pajisur me NUIS L71816014C me 1 (një) kuote me vlere 100 000 leke (njëqind mije leke) qe përfaqësojnë 100% te kapitalit te saj themeltar me Ortake te vetëm Z. Abaz Nezir DINO.

Kjo Kontrate u përpilua ne katër kopje me vlere te njëjte ligjore, e cila pasi lexohet prej palëve te interesuara me zë te larte e te qarte, kuptohet prej tyre, deklarohet se u gjet e përpiluar ne përputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote si dhe me Ligjin e për rrjedhojë u nënshkrua rregullisht prej tyre si me poshtë.

SHITESI

Miranda Thoma Boçi

Miranda Thoma Boçi
30.04

BLERESI

Abaz Nezir Dino

Abaz Dino